



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 429/4 Prot.

Tiranë, më 28/05/ 2021

V E N D I M

Nr. 91 , Datë 28 /05/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.34 Regj, datë 05.03.2021, që i përket ankueses M.B, kundër Njësisë Administrative Pezë, Tiranë², me pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, gjendjes martesore, gjendjes civile. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur, ankuesja deklaron se është bashkëshortja e të ndjerit A.B, të vrarë me armë zjarri më datë 30.01.2019. Pas kësaj ngjarje, rreth muajit maj 2019, ankuesja është vënë në dijeni se kishin filluar disa probleme me pasurinë e tyre të paluajtshme, e llojit arë, e ndodhur në fshatin Pezë e Vogël, Tiranë. Për këtë pasuri familja e ankueses dhe e kunatit të saj, shtetasit të quajtur A.B, janë të pajisur me çertifikatë pronësie.

Rreth muajit qershor 2019, ankuesja shprehet se, ka filluar të kërkojë fillimisht verbalisht dhe pastaj me kërkesë me shkrim, të drejtën për të gëzuar lirisht pronën e tyre. Për shkak të hasmërisë, ankuesja shprehet se kunati i saj, shtetasi A.B, si i vetmi i familjes B, nuk dilte nga shtëpia.

Gjatë kësaj kohe, ankuesja ka hasur një pengesë të jashtëzakonshme nga ana e Administratorit të Njësisë Administrative Pezë, z. B.K, i cili i ka nxjerrë pengesa të pabazuara në ligj. Këto pengesa

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Njësia.

të pabazuara nga ana e Administratorit të Njësisë Pezë, janë konstatuar edhe nga Avokati i Popullit, me disa rekomandime që ka nxjerrë ky institucion.

Ankuesja deklaron se, ka rreth dy vjet që nuk i jepet e drejta për të gëzuar, dispozuar dhe tjetërsuar lirisht pronën, e drejtë kjo sipas Kushtetutës, Kodit Civil dhe ligjit nr.8338, datë 30.04.1998 “*Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave*”, për lëshimin e vërtetimit që vërteton përbërjen e familjes bujqësore në datën e kërimit prej subjektit pronar/bashkëpronar mbi pasurinë e paluajtshme. Ankuesja shprehet ende nuk i është dhënë ky vërtetim, i cili është detyrim ligjor i Njësisë Administrative Pezë.

Sipas ankuesës, e gjithë kjo ndodh pasi ajo është një grua e ve, e vetme dhe për shkak se janë familje në hasmëri dhe këto veprime bëhen me vetëdije të plotë nga Administratori i Njësisë Pezë, z. B. K.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri që të garantojë barazinë dhe të sigurojë mbrojtje nga diskriminimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji Nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *gjinisë, gjendjes familjare, gjendjes martesore, gjendjes civile*, të pretenduara nga ankuesja si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, **gjininë**, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, **gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile**, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenti 7 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.429/1 prot., datë 19.03.2021, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Njësia. Me shkresën nr.350/1 prot., datë 01.04.2021³, Njësia, ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar si më poshtë:

Familja e përfaqësuar nga znj.K.B, është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr.220/49, lloji i pasurisë “arë”, zona kadastrale nr.3714, volumi 4, faqe 84, me sipërfaqe 2300 m2, të ndodhur në Varosh, Njësia Administrative Pezë. Për këtë pasuri ankuesja, në cilësinë e përfaqësueses me prokurë të znj. K.B, ka paraqitur një ankesë me nr.626 prot., datë 03.07.2019, ku ankohet për zaptimin e tokës të marrë në bazë të AMT-së, sipas ligjit nr.7501/1991, nga familja V. Për paanshmëri në trajtimin e kësaj ankese, Njësia me shkresat nr. 652 prot datë 08.07.2019 dhe nr. 652/2 prot., datë 24.07.2019, i është drejtuar shtetasve S.V dhe A.V me kërkesë për të depozituar pranë këtij institucione dokumentacionin e pronësisë që ata dispononin. Të dy këta shtetas kanë kthyer përgjigje me shkresat nr. 652/1 prot datë 16.07.2019 dhe nr. 652/3 prot datë 31.07.2019.

Njësia shprehet se, kërkesën e ankueses, së bashku me dokumentacionin e depozituar nga familja V, me shkresën nr.626/1 prot., datë 02.08.2019, e ka dërguar për ndjekje pranë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Liçencimit, në Bashkia Tiranë. Për të shmangur çdo ngjarje konfliktuale që mund të ndodhte ndërmjet familjeve, Njësia shprehet se me shkresën nr.820 prot., datë 06.09.2019 i është drejtuar Komisariatit të Policisë Nr.6.

Me shkresën nr. 878 prot., datë 30.09.2019, ankuesja ka paraqitur kërkesë për autorizim për shitje toke për pasurinë me nr.73/28, me sipërfaqe 2050, zona kadastrale 2952 dhe për pasurinë me nr.220/49 me sipërfaqe 2300 m3, zona kadastrale 3714.

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.429/2 prot., datë 06.04.2021.

Për shkak të problematikës së mësipërme, Njësia shprehet se ka kërkuar informacion nga kryesia e fshatit Pezë e Vogël, e cila ka konfirmuar se pasurinë e llojit “arë” me nr.220/49 me sipërfaqe 23000 m², zona kadastrale 3715, me emrin popullor Limole e punon familja V. Njësia i ka kthyer përgjigje ankueses me shkresën nr.878/3 prot., datë 02.10.2019.

Njësia parashtron se, ankuesja ka bërë kërkesë për autorizim për shitje toke, për pasurinë e mësipërme edhe me shkresat nr.1238 prot., datë 16.12.2019 dhe nr.4 prot., datë 06.01.2020. Për këto kërkesa, Njësia deklaron se i ka kthyer përgjigje ankueses me shkresën nr.4/1 prot., datë 22.01.2020. Duke u nisur nga kërkesat e vazhdueshme të ankueses, Njësia shprehet se me shkresën nr.4/2 prot. datë 31.01.2020, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, pranë Bashkisë Tiranë duke kërkuar informacion mbi ecurinë e shkresës së dërguar prej tyre nr.626/1 prot., datë 02.08.2019.

Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve, me shkresën nr. 5650/2 prot., datë 05.03.2020, shprehet se bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Njësia i ka të përcaktuara kompetencat e saj dhe Sektori i AMTP-ve pranë Bashkisë Tiranë nuk ka tagër të shprehet në lidhje me shkresën e sipërcituar. Sipas Njesisë objekti i kërkesës së ankueses, për pushtim toke nuk ishte trajtuar nga kjo drejtori edhe pse sipas saj hynte në kompetencat e saj. Në vijim Njësia shprehet se, me shkresën nr.874 prot., datë 26.06.2020, i është drejtuar Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve për ndjekjen e kësaj çështje. Kjo drejtori me shkresën nr. 874/1 prot., datë 06.08.2020, i ka kthyer përgjigje Njesisë në lidhje me çështjen.

Me shkresën nr. K3/M29-2 prot., datë 16.06.2020, Njësia shprehet se ka marrë një kërkesë për shpjegime nga ana e Avokatit të Popullit, i cili ishte vënë në lëvizje nga ankesa e M.B. Me shkresën nr. K/3M29-7 prot., datë 09.09.2020, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Njesisë lëshimin e vërtetimit, që vërteton përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë së paluajtshme të regjistruar me nr.220/49, volumi 4, faqe 74, zona kadastrale 3714.

Në vijim të kërkesave dhe rekomandimeve të njëpasnjëshme të Avokatit të Popullit, bazuar në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjeve, livadheve dhe kullotave”, neni 5, gërma “b”, dhe në dokumentacionin e depozituar nga M.B, Njësia deklaron se ka lëshuar vërtetimin për përbërjen familjare sipas çertifikatës familjare aktuale, përcjellë me shkresën nr.120/3 prot., datë 04.03.2021.

Njësia shprehet se, në lidhje me problematikën e krijuar me familjen V, familja B ndër vite ka paraqitur kërkesë-ankesa, sikundër shkresa nr.263 prot., datë 07.04.2014, kërkesa për zënien e tokës, paraqitur nga znj. K.B me nr.1208 prot., datë 23.11.2017, të cilës i është kthyer përgjigje

nga ana e Njesisë me shkresën nr. 1208/1 prot datë 11.12.2017, si dhe kërkesa e paraqitur nga ankuesja M.B me nr.591 prot., datë 19.06.2019 ku shprehet se prej vitesh familja V nuk i ka lënë të gëzojnë të drejtën e pronësisë.

Njësia thekson se, sipas deklarimeve të vetë ankueses, këtë lloj problematike në formë shkresore ajo e ka paraqitur edhe në institucione të tjera si Portali i Bashkëqeverisjes, Kryeministri, Avokati i Popullit, Ambasada Amerikane, Bashkia e Tiranës dhe Emisioni STOP.

Njësia shprehet se, ajo ka shqyrtuar çdo kërkesë-ankesë të paraqitur nga ankuesja dhe ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipas Njesisë, pretendimi i shprehur nga ankuesja është i pabazuar, pasi kërkesa për pajisjen me vërtetimin e përbërjes së familjes bujqësore aktuale është trajtuar dhe ankuesja ka marrë shërbimin përkatës.

2. Ankuesja depozitoi kundërshtimet e saj në lidhje me qëndrimin e Njesisë, të cilat u administruan pranë Komisionerit me nr.429/3 prot., datë 20.04.2021, duke parashtruar si vijon:

Sipas ankueses, gjithçka që është shkruar në shkresën nr.350/1 prot., datë 01.04.2021 nga ana e Njesisë, tregon sorrollatjet dhe pengesat e pafundme të bëra nga Administratori i Njesisë Administrative Pezë, z.B.K, pengesë e cila vazhdon të rëndojë mbi familjen B dhe mbi vetë ankuesen, si dhe përbën cënim të të drejtës për të gëzuar, disponuar dhe tjetërsuar lirisht pronën.

Ankuesja shpjegon se, familja B, në vitin 1991 ishte një familje bujqësore me banim dhe anëtare e kooperativës bujqësore, dhe si e tillë është trajtuar me tokë bujqësore sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) datë 01.12.1991, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Fshatit Pezë, në emër të kryefamiljarit D.B. Ky i fundit ka ndërruar jetë në datë 12.02.1991, pra nuk ka qenë pjestar i kësaj familje më datë 01.08.1991, kur është ndarë toka bujqësore. Nga sa më sipër, ankuesja shprehet se familja B ka ndërmarrë disa procese pranë organeve kompetente duke kërkuar korrigjimin e gabimit material të AMTP-së. Konkretisht, me vendimin nr. 2874 datë 07.06.2016 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur: “ *Korrigjimin e gabimit material të AMTP datë 01.12.1992, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Fshatit Pezë, për sa i përket përfaqësuesit të familjes bujqësore nga D.B në K. B*”. Ky vendim ka marrë formë të prerë. Ndërsa në vendimin me nr.265 datë 28.10.2016, të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefektit të Qarkut Tiranë, në të cilin është vendosur për shfuqizimin e pjeshëm të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, ndër të tjerash pasqyrohet se pasi ky komision ka kërkuar informacion nga Njësia Administrative Pezë, kjo e fundit me shkresën nr. 705/1 prot., datë 10.08.2015, ka konfirmuar se: “ *...parcelat e përfituara me AMTP e z.B kanë qenë pjesë e ish-kooperativës bujqësore, përdoren nga familja B si dhe nuk ka ankesa apo pretendues të tjerë në lidhje me to....* ”

Më datë 17.08.2017, ankuesja shprehet se kanë bërë regjistrimin e 3 certifikatave të pronësisë të tokës arë, marrë në bazë të AMTP-së dhe konkretisht: certifikatën nr.1720871, me sipërfaqe 2050.00 m2, certifikatën nr. 1720869, me sipërfaqe 2300.00 m2 dhe certifikatën nr.1720870, me sipërfaqe 1570.00 m2.

Në datën 30.01.2019, ankuesja deklaron se është vrarë me armë zjarri bashkëshorti i saj, shtetasi A.B, djali i tretë i vrarë i familjes B.

Në datën 30.09.2019, ankuesja deklaron se i është drejtuar Njësisë, në një kërkesë të vetme, me nr.878 prot., datë 30.09.2019, me të cilën ka kërkuar autorizim për shitjen e 2 parcelave tokë, lloji i pasurisë “arë” si vijon: “ - Pasurinë e paluajtshme, me zonë kadastrale nr.2952, nr.pasurie 73/28, volumi 3, faqe 117, me sipërfaqe 2050.00 m2; - Pasurinë e paluajtshme, me zonë kadastrale nr.3714, nr.pasurie 220/49, volumi 4, faqe 84, me sipërfaqe 2300.00 m2.

Në datën 02.10.2019, ankuesja deklaron se ka marrë vërtetim vetëm për njërin nga pasuritë për të cilat kishte aplikuar dhe konkretisht për pasurinë me nr. 73/28. Për këtë pasuri, ankuesja deklaron se në datën 02.10.2019, familja B ka lidhur para noterit kontratë për shitjen e tokës, ku pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga ligji përfshihet edhe vërtetimi i datës 02.10.2019, lëshuar nga Njësia.

Pas datës 30.09.2019, ankuesja deklaron se ka bërë disa kërkesa drejtuar Njësisë për marrjen e autorizimit/vertetimit për shitjen e parcelës tjetër të tokës arë, me nr.pasurie 220/49, (sikundër kishte kërkuar edhe në datën 30.09.2019), dhe konkretisht kërkesat e dërguara në datë 03.12.2019, 06.12.2019, 18.12.2019 dhe 27.12.2019. Ankuesja shprehet se kërkesa e bërë prej saj në datën 30.09.2019 dhe në vazhdim kërkesat e tjera, nuk janë plotësuar nga ana e Njësisë.

Ankuesja sqaron se në lidhje me situatën, ka bërë me dije Avokatin e Popullit, i cili vazhdon të ndjekë problematikën e saj, deri në plotësimin e kërkesës . Me shkresën nr. K3/M29-16 prot., datë 04.05.2021, të vendosur në dispozicion nga ankuesja, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Njësia rishikimin e aktit të nxjerrë, në përmbushje të rekomandimit të dërguar nga ana e tyre.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie me nr. 1456523, lëshuar në datë 15.09.2020, nga ZVRPP DR.Rurale 2, Tiranë, rezulton se, ankuesja është bashkëpronare në një pasuri të paluajtshme, e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 2300.00 m2, ndodhur në Varosh, Tiranë, me nr. pasurie 220/49, zona kadastrale 3714, volumi 4, faqe 84. Bazuar në aktet dhe informacionin e

administruar, kjo pasuri e paluajtshme rezulton të jetë përfitua në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar.

Ankuesja ka paraqitur pranë Njesisë, një kërkesë, e cila rezulton të jetë protokolluar me nr. 878 prot datë 30.09.2019, me anë të të cilës ka kërkuar autorizim për shitjen e dy parcelave tokë, të llojit “arë” duke përfshirë edhe pasurinë e mësipërme, dhe konkretisht :

- 1- Pasurinë e paluajtshme, me zonë kadastrale nr.2952, nr.pasurie 73/28, volumi 3, faqe 117, lloji i pasurisë “arë”, sipërfaqe 2050.00 m² ;
- 2- Pasurinë e paluajtshme, me zonë kadastrale nr.3714, nr.pasurie 220/49, volumi 4, faqe 84, lloji i pasurisë “arë”, sipërfaqe 2300.00 m².

Me shkresën nr. 878/3 prot., datë 02.10.2019, Njësia i ka kthyer përgjigje ankueses, në lidhje me kërkesën e mësipërme, duke i vendosur në dispozicion dhe duke i lëshuar vërtetimin datë 02.10.2019, vetëm për pasurinë e paluajtshme, me zonë kadastrale nr.2952, nr.pasurie 73/28, volumi 3, faqe 117, lloji i pasurisë “arë”, sipërfaqe 2050.00 m². Sa i takon pasurisë me nr.220/49, zona kadastrale 3714, Njësia shprehet se, për arsye të problematikës që mbart kjo pasuri kërkesa nuk mund të plotësohet dhe Njësia nuk i ka lëshuar ankueses vërtetim, sikundër në rastin e pasurisë tjetër për të cilin ankuesja kishte aplikuar bashkarisht.

Ankuesja ka bërë disa kërkesa të tjera (shkresë dërguar me postë në datë 03.12.2019, shkresë nr.1283 prot, datë 16.12.2019, shkresë nr. 1342 prot, datë 18.12.2019, shkresë nr. 4 prot datë 06.01.2020) drejtuar Njesisë, për marrjen e autorizimit dhe lëshimin e vërtetimit me qëllim tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme të llojit arë, me nr.pasurie 220/49, zona kadastrale 3714, volumi 4, faqe 84, me sipërfaqe 2300 metra katror, por nuk ka arritur të marrë shërbimin e kërkuar.

Ankuesja ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr. 34 regj datë 05.03.2021, duke pretenduar se është viktimë e diskriminimit për shkak të gjinisë, gjendjes familjare, gjendjes civile dhe gjendjes martesore, pasi vërtetimi i kërkuar prej saj edhe pse detyrim ligjor i Njesisë dhe një e drejtë e saj kushtetuese për të gëzuar dhe disponuar lirisht pronën, nuk i është lëshuar, për shkak se familja B, pra ankuesja dhe kunati i saj shtetasi A.B, janë familje në hasmëri dhe se ankuesja është grua e ve dhe e vetme.

Tjetërsimi i pasurive të paluajtshme, si në rastin e çështjes objekt shqyrtimi, rregullohet sipas ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”. Bazuar në nenin 5, të ligjit të cipërcituar, përcaktohet si vijon: “Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësorë, pyjore, livadhet, kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese: a) Certifikatën e

vërtetimit të pronësisë të zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendndodhjes së pronës. b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes. c) Skicën topografike të pasurisë që do të jetë objekt i kalimit të pronësisë. ç) Prokurën noteriale të përfaqësimit, kur kalimi i pronësisë nuk kryhet nga gjithë anëtarët e familjes bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme.”

Bazuar në rregullimin e mësipërm ligjor, ankuesja i është drejtuar Njësisë në datën 30.09.2019, për të marrë autorizimin dhe për t’u pajisur me aktin përkatës, që do t’i mundësonte asaj tjetërsimin e dy pasurive të paluajtshme, të llojit “arë”, njëra me sipërfaqe 2300.00 m2, regjistruar me zonën kadastrale nr.3714, nr.pasurie 220/49, volumi 4, faqe 84 dhe tjetra me sipërfaqe 2050.00 m2, regjistruar me zonën kadastrale nr.2952, nr.pasurie 73/28, volumi 3, faqe 117, në të cilën ankuesja gëzon të drejta pronësie, në cilësinë e bashkëpronares.

Sikundër citohet edhe më sipër, ankuesja është pajisur me aktin e kërkuar nga ligji për tjetërsimin e tokës bujqësore ku ajo është bashkëpronare, vetëm për pasurinë me nr.73/28, ndërsa për pasurinë me nr.220/49, që është edhe objekt shqyrtimi, ankueses i është refuzuar pajisja me aktin përkatës dhe nuk i është lëshuar vërtetimi, me justifikimin se kërkesa për këtë pasuri nuk mund të plotësohej për shkak të problematikës që mbart pasuria. Pavarësisht kërkesave të përsëritura nga ankuesja për lëshimin e vërtetimit për pasurinë nr.220/49, Njësia ka refuzuar lëshimin e këtij akti me justifikimin se për këtë pasuri ka probleme posedimore.

Në përgjigje të kërkesës së ankueses për lëshimin e vërtetimit me qëllim tjetërsimin e tokës bujqësore, protokolluar me nr.4 prot., datë 06.01.2020, Njësia me shkresën nr. 4/1 prot datë 22.01.2020, shprehet se : *“Për këtë pasuri ju keni paraqitur pranë Njësisë Administrative Pezë një “Kërkesë” me nr.626 prot., datë 03.07.2019, ku shpreheni në lidhje me zaptimin e kësaj pasurie nga familja V dhe Njësia Administrative këtë kërkesë e ka adresuar me shkresë nr.626/1 prot., datë 02.08.2019 “Për ndjekje” Bashkisë Tiranë.”*

Në vijim të shkresës nr. 4 prot datë 06.01.2020 të paraqitur nga ankuesja, rezulton se Njësia i është drejtuar Bashkisë Tiranë, me shkresën nr.4/2 prot., datë 31.01.2020, ku ndër të tjera kërkon informacion lidhur me ndjekjen e ankesës për zaptim toke që ajo kishte përcjellë pranë Bashkisë Tiranë shkresën nr. 626/1 datë 02.08.2019, ku ndër të tjera shprehet se: *“Në këto kushte ne si Njësi Administrative, duhet të lëshojmë këtë vërtetim të kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga familja B, apo duhet pritur përfundimi mbi ecurinë e shkresës”.*

Referuar nenit 5/b, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 *“Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”*, vërtetimi i pushtetit lokal, përfaqësuar nga Njësia në rastin në fjalë, që vërteton përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, si një dokument i

domosdoshëm për të kryer tjetërsimin e tokës bujqësore sipas kësaj dispozite, nuk kushtëzohet me faktin apo verifikimin nëse ka ose jo problemeve posedimore mbi pasurinë që do të tjetërsohet. Sipas këtij parashikimi ligjor, vërtetimi i kërkuar nga pushteti lokal, ka si qëllim vetëm vërtetimin e përbërjes së familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë.

Ankuesja, me të drejta bashkëpronësie në pasurinë e paluajtshme objekt shqyrtimi, e gëzon këtë të drejtë bazuar në certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse dhe nuk rezulton që të ketë ndonjë vendim gjyqësor që të ketë urdhëruar bllokimin e kësaj pasurie apo ndonjë urdhërim tjetër për moskryerjen e veprimeve juridike që synojnë tjetërsimin e kësaj prone.

Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia, rezulton se problematikat në lidhje me këtë pasuri kanë ekzistuar edhe më parë, duke cituar këtu, një ankesë të bërë në vitin 2014 nga shtetasi A.B, një ankesë të bërë nga shetasja K.B në vitin 2017. Në këto ankesa është parashtruar problematika e zaptimit të tokës nga familja V. Bazuar në aktet e administruara, problematikat e mësipërme, nuk e kanë penguar familjen B, që të pajiset që në datë 17.08.2017, me certifikatë pronësie për pasurinë nr.220/49, periudhë në të cilën kanë ekzistuar të njëjtat problematika në lidhje me posedimin e pasurisë, por një fakt i tillë nuk ka cënuar të drejtën e palës pronare për t'u pajisur me certifikatë pronësie.

Rezulton se Njësia ka mbajtur një korrespondencë me Bashkinë e Tiranës në lidhje me shkresën nr.626/1 prot., datë 02.08.2019, nëpërmjet të cilës ka përcjellë pranë këtij institucioni ndjekjen e problematikës që ankuesja kishte parashtruar për zaptimin e tokës. Kjo praktikë e përcjellë nga Njësia, pranë Bashkisë Tiranë, përbën edhe justifikimin e parashtruar nga ana e Njesisë për mospajisjen e ankueses me shërbimin e kërkuar dhe lëshimin e vërtetimit, për tjetërsimin e tokës bujqësore sipas ligjit.

Me shkresën nr. 5650/2 prot datë 05.03.2020, Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve, pranë Bashkisë Tiranë, i është drejtuar Njesisë duke i komunikuar se kompetencat e kësaj të fundit janë të përcaktuara në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe se Sektori i AMTP-ve pranë Bashkisë së Tiranës nuk ka tagër të shprehet për sa kërkohet në shkresën nr. 4/2 prot., datë 31.01.2020 dërguar nga Njësia.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, rezulton se me shkresën nr.874 prot datë 26.06.2020, Njësia e ka dërguar përsëri çështjen, për ndjekje pranë Bashkisë Tiranë. Kjo e fundit, me shkresën nr. 5650/4 prot datë 03.08.2020, ka kërkuar nga Njësia, që të verifikojë kompetencat e saj referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” duke mos deleguar më pranë Sektorit të AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, veprimtaria administrative e ndjekur nga ana e Njesisë, duke e përcjellë çështjen për trajtim pranë Bashkisë së Tiranës me shkresën nr. 626/1

prot, datë 02.08.2019, rezulton e pambështetur në ligj. Në mënyrë të përsëritur Bashkia e Tiranës, ka bërë me dije Njësia se është kjo e fundit që duhet të trajtojë kërkesën e ankueses.

Sa më sipër rezulton se, refuzimi për lëshimin e vërtetimit të kërkuar nga ankuesja me qëllim shitjen e tokës bujqësore, është i pabazuar në ligj. Njësia, duhet të kishte pajisur ankuesen me vërtetimin e kërkuar sipas kërkesës së bërë prej saj në datën 30.09.2019, sikundër ka vepruar për pasurinë tjetër, për të cilën i ka lëshuar ankueses vërtetimin e datës 02.10.2019.

Për problematikën e mos lëshimit të vërtetimit, ankuesja rezulton t'i jetë drejtuar edhe Avokatit të Popullit, i cili, me shkresën nr.K3/M29-7 prot., datë 09.09.2020, i ka rekomanduar Njesisë lëshimin e menjëhershëm të vërtetimit që vërteton përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë të pasurisë së paluajtshme, objekt shqyrtimi.

Me shkresën nr. 120/3 prot datë 04.03.2021, Njësia në përmbushje të rekomandimit të mësipër të dhënë nga Avokati i Popullit dhe pas kërkesës së depozituar nga ankuesja në datën 16.02.2021, ka vendosur në dispozicion të ankueses vërtetimin me datë 03.04.2021.

Sa më sipër, Njësia parashtron se pretendimet e ankueses se nuk e ka marrë shërbimin e kërkuar janë të pabazuara, pasi ajo është pajisur me vërtetimin e kërkuar. Ankuesja prapësoi se, vërtetimi që i është vendosur në dispozicion me shkresën e mësipërme, nuk është është akti i kërkuar prej saj.

Nga verifikimi i vërtetimit të lëshuar nga Njësia, në datë 04.03.2021, rezulton se, ky vërtetim pasqyron përbërjen familjare të ankueses në çastin e lëshimit të vërtetimit dhe jo përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, sikurse është kërkuar nga ankuesja. Kërkesa për lëshimin e vërtetimit me qëllim tjetërsimin e tokës bujqësore, është kërkuar nga ankuesja në datë 30.09.2019 për dy pasuri. Vërtetimi i lëshuar nga Njësia për njërin prej pasurive në datën 02.10.2019, nuk rezulton të jetë i njëjtë, as në formë dhe as në përmbajtje me vërtetimin e lëshuar nga Njësia në datën 3.04.2021. Në vërtetimin e datës 02.10.2019, Njësia ka pasqyruar përbërjen e familjes bujqësore në çastin e fitimit të pasurisë, pra përbërjen e familjes bujqësore në datë 01.08.1991, si dhe përbërjen e familjes bujqësore në çastin e lëshimit të vërtetimit. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur me vërtetimin e lëshuar nga Njësia në datën 04.03.2021, me lëshimin e të cilit ajo pretendon se ka përmbushur kërkesën e ankues.

Komisioneri vlerëson se, pretendimi i Njesisë se ka lëshuar vërtetimin e kërkuar nga ankuesja, është i pabazuar, pasi vërtetimi i lëshuar në datë 04.03.2021 nuk përmbush kërkesat e ligjit. Njësia ka qenë plotësisht në dijeni të thelbit të kërimit të ankueses dhe qëllimit për të cilin ajo ka kërkuar vërtetimin, vërtetim të cilin Njësia e ka lëshuar në formën e duhur me vërtetimin e datës 02.10.2019, por nuk e ka bërë një gjë të tillë me vërtetimin që ka lëshuar në datë 04.03.2021.

Me shkresën Nr. K3/M29-16 prot, datë 4.5.2021, të Avokatit të Popullit, e cila u vendos në dispozicion nga ana e ankueses, rezulton se Avokati i Popullit ka kërkuar nga Njësia rishikimin e aktit të nxjerrë, në zbatim të rekomandimit të këtij institucioni.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk e ka marrë shërbimin e kërkuar nga Njësia Administrative Pezë, pasi nuk është pajisur me vërtetimin formën e kërkuar nga ligji për tjetërsimin e tokës bujqësore në të cilën ankuesja është bashkëpronare. Për rrjedhojë Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga Njësia Administrative Pezë.

B. Shkaku i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, por duke parashikuar mbrojtje të drejtëpërdrejtë për shkak të *gjinisë, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile*, të cilat janë shkaqet mbi bazën e të cilave ankuesja pretendon se është diskriminuar.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010“*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkak të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Për të ngritur një pretendim për diskriminim, pala ankuese duhet që minimalisht, jo vetëm të identifikojë një ose disa shkaqe mbi bazën e të cilave pretendohet diskriminimi, por duhet edhe të provojë shkaqet e pretenduara.

Në rastin në fjalë, ankuesja pretendon se trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm të cilit i është nënshtruar, ka si bazë më shumë se një shkak. Konkretisht, ankuesja pretendon se është diskriminuar pasi nuk është pajisur me vërtetimin e nevojshëm për tjetërsimin e tokës bujqësore, për shkak të *gjinisë, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile*.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe i është mohuar barazia për shkak të *gjinisë*, pasi ajo është femër. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson të provuar këtë shkak të pretenduar nga ankuesja.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes familjare ose martesore dhe gjendjes civile, ankuesja nuk identifikon ose sqaron në mënyrë të ndarë, se si pretendimet e saj se është grua e ve, e vetme dhe familje në hasmëri për ligjin secilin prej shkaqeve të mësipërme të identifikuar nga ana e saj si shkaqe diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, gjendja familjare ose martesore, janë shkaqe që kanë të bëjnë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore, të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare ose martesore, mund të ndryshojë ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose një numër të caktuar fëmijësh, ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët ose persona të tjerë në ngarkim. Në këtë kuptim, elemëtë të tillë si fakti që një person është i martuar ose beqar, i divorcuar ose i ve, janë elemëtë që mbivendosen me shkakun e gjendjes civile, i cili sipas ligjit përbën një shkak më vete të mbrojtur në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga ligji.

Nga aktet e administruara, ankuesja rezulton me gjendje civile e ve dhe referuar përbërjes së saj familjare ajo aktualisht jeton së bashku me dy vajzat e saj. Ankuesja thekson se trajtimi i saj i padrejtë dhe i pafavorshëm është rrjedhojë jo vetëm e faktin se ajo është e ve, por ky statusi i saj civil, është ngushtësisht i lidhur me përbërjen dhe situatën e saj familjare.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimet e ankueses se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme për shkak se, është e ve dhe e vetme me dy vajzat e saj, duhet të gëzojnë mbrojtje në kuadër të gjendjes familjare dhe martesore, pasi elementi i gjendjes civile i pretenduar veçmas nga ankuesja është i përfshirë. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e gjendjes familjare ose martesore.

Gjithashtu, ankuesja pretendon se, shkak i trajtimit të saj të padrejtë është edhe fakti se familja B, është një familje në hasmëri. Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesja ka depozituar vetëm disa fotografi ku shfaqen pamjet e tre varreve, që sipas mbishkrimeve, i përkasin shtetasve B.B, A.B dhe L.B, të cilët sipas deklarimeve të ankueses, janë djemtë e familjes B, duke përfshirë edhe bashkëshortin e saj, të cilët janë vrarë si pasojë e hasmërisë. Ankuesja deklaron se, aktualisht është gjallë vetëm kunati i saj, shtetasi A.B, i cili për shkak të hasmërisë nuk del nga shtëpia. Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankueses në lidhje me ekzistencën e hasmërisë në familjen B, bazuar vetëm në të dhënat e mësipërme, mbetet i paprovuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 41 të Kushtetutës, dispozitë kjo që garanton të drejtën e pronës.

Neni 1, i Protokollit Nr. 1, të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën e pronës, duke sanksionuar se, çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij.

Njësia, nëpërmjet sjelljes së saj, duke mos lëshuar aktin e kërkuar nga ligji për tjetërsimin e tokës bujqësore në të cilën ankuesja është bashkëpronare, ka cënuar të drejtën e ankueses për të gëzuar lirisht pronën duke e penguar atë që të disponoj dhe tjetërsojë pronën në bashkëpronësi të saj.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Referuar nenit 3, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se : “3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”.

Për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më tepër se një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Bazuar në nenin 33, pika 7/1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.⁴

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm.

Ankuesja pretendon se, trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm, të cilit i është nënshtruar, ka si bazë më shumë se një shkak dhe konkretisht, ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të gjinisë, gjendjes familjare ose martesore, pasi nuk është pajisur me vërtetimin e nevojshëm për tjetërsimin e tokës bujqësore, për shkak se ajo është grua, e ve dhe e vetme. Referuar pretendimeve të parashtruara nga ankuesja, rezulton se gjina e ankueses dhe gjendja e saj familjare dhe martesore, si e ve dhe e vetme, janë të ndërlidhura dhe bashkëveprojnë me njëra në të njëjtën kohë për të prodhuar sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ankuesja. Referuar shpjegimeve të ankueses nuk është thjesht fakti se ajo është grua, që ka ndikuar në trajtimin e padrejtë të pretenduar prej saj, por ky shkak është ngushtësisht i lidhur me faktin që ankuesja është grua e gjendur në një situatë të caktuar familjare dhe martesore dhe konkretisht një grua e ve dhe e vetme.

Nga aktet dhe informacioni i administruar rezulton se ankuesja e gjendur në të njëjtat kushte për të cilat pretendon se kanë shërbyer si bazë për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit i është nënshtruar, pra një grua e ve dhe e vetme, është pajisur nga Njësia me vërtetimin e datës 02.10.2019. Pra, Njësia ka lëshuar vërtetim të ligjshëm për ankuesen e ndodhur në të njëjtat kushte, në lidhje me pronë tjetër, çka dëshmon që veprimi paligjshëm i Njesisë nuk lidhet me shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Referuar shpjegimeve të ankueses, kjo e fundit e lidh pretendimin e saj për diskriminim me momentin e vdekjes së bashkëshortit të saj në datën 30.1.2019. Sikundër shprehet në ankesë, ankuesja deklaron se disa muaj pas vdekjes së bashkëshortit të saj, ajo ka marrë dijëni për disa probleme në lidhje me pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të familjes B. Rreth muajit qershor 2019, ankuesja deklaron se ka filluar të kërkojë të drejtën për të gëzuar lirisht pronën e saj. Ankuesja shprehet se pengesat e pabazuara në ligj nga ana e Administratorit të Njesisë Administrative Pezë, bazohen dhe kanë si shkak faktin se ajo është grua e ve dhe e vetme. Bazuar në shpjegimet e ankueses, kjo e fundit nuk referon në problematika në lidhje me pasurinë e paluajtshme para se bashkëshorti i saj të ndërronte jetë, duke lënë të kuptohet se problematikat dhe

⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

ndryshimi i sjelljes nga ana e Njësië kanë filluar nga momenti që ka ndërruar jetë bashkëshorti i ankueses.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se familja B, ka patur problematika në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përfituara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar përfshirë edhe pasurinë për të cilën ka kërkuar, por nuk është pajisur me vërtetim, edhe para se ankuesja të mbetej e ve. Referuar akteve të vëna në dispozicion nga Njësia, rezulton së në një rast në vitin 2014 ka qenë bashkëshorti i ankueses, i cili ka bërë ankesë për zaptimin e tokës nga familja me të cilën pretendohet se ka problematika në lidhje me posedimin e pasurisë së paluajtshme. Vetë ankuesja në një ankesë drejtuar njëkohësisht Bashkisë Tiranë dhe Njësisë, në datë 03.07.2019, shprehet se për problematikën e zaptimit të tokës edhe pse ka bërë ankesa pranë këtyre dy institucioneve gjatë vitit 2017 dhe 2018, nuk ka marrë një zgjidhje në lidhje me këto problematika.

Rezulton plotësisht e provuar se, refuzimi i Njësisë për të lëshuar aktin e kërkuar nga ligji për tjetërsimin e tokës bujqësore, është një sjellje e pabazuar e cila e ka vendosur ankuesen në një situatë të padrejtë dhe të pafavorshme. Por pavarësisht këtij fakti dhe ekzistencës së shkaqeve të mbrojtura të diskriminimit si gjinia, gjendja familjare ose martesore, konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkaqeve të mbrojtura, nuk mund të çojnë *a priori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është cilido nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Aktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të për të prezumuar dhe krijuar bindjen se kjo sjellje, të cilës i është nënshtruar ankuesja, është rezultat i shkaqeve të mbrojtura dhe se në mungesë të tyre ankuesja do të ishte trajtuar ndryshe.

Referuar standartit të provës të parashikuar nga neni 33, pika 7/1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u arritën të administroheshin fakte dhe prova mbi bazën e të cilave mund të prezumohet se ka patur sjellje diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Njësia nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja nuk përbën diskriminim.

Duke ritheksuar faktin se veprimet e Njësisë për të mos pajisur ankuesen me vërtetimin e kërkuar janë plotësisht të pabazuar dhe kanë sjellë si pasojë cënimin e të drejtës së ankueses për të gëzuar lirisht pronën në të cilën është bashkëpronare, Komisioneri dëshiron të theksojë se, sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën

diskriminim. Sjellja në kundërshtim me ligjin e konsumuar nga ana e Njesisë Administrative Pezë, duke mos e pajisur ankuesen me aktin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për tjetërsimin e tokës bujqësore në bashkëpronësi të ankueses, është trajtuar dhe po ndiqet plotësimi i kërkesës së ankueses për t'u pajisur me aktin përkatës, nga ana e Avokatit të Popullit.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa për diskriminim e paraqitur nga ankuesja kundër Njesisë Administrative Pezë, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pikat 10 e 11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses M.B, për shkak të gjinisë, gjendjes familjare ose martesore, nga ana e Njesisë Administrative Pezë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Gjinia, gjendja familjare dhe martesore
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim